

Nga Politika në Praktikë

Sfidat e Ndotjes së Lumenjve dhe Menaxhimit të Mbeturinave në Kosovë

Shtator 2023





**NGA POLITIKA NË PRAKTIKË
SFIDAT E NDOTJES
SË LUMENJVE DHE
MENAXHIMIT TË
MBETURINAVE NË KOSOVË**



Vizitoni ueb faqen tonë
www.dplus.org

Mësoni më shumë rreth publikimeve tona të fundit,
lajmeve dhe infografikave online.



Na gjeni në Facebook
[@democracyplus](https://www.facebook.com/democracyplus)



Na gjeni në LinkedIn
[@democracy-plus](https://www.linkedin.com/company/democracy-plus)



Na gjeni në Twitter
[@democracy_plus](https://twitter.com/democracy_plus)



Na gjeni në Youtube
[@Democracy-Plus](https://www.youtube.com/Democracy-Plus)

Zyret tona:

Rruga Bajram Kelmendi, Nr. 92, Kati V
Prishtinë, 10000
Kosovë

+383 (0) 38 749 288
info@dplus.org

Përmbajtja

Hyrje	7
Përmbledhje ekzekutive	8
Metodologjia e Hulumtimit.....	8
Gjetjet Kryesore	8
Korniza	9
Ndotja e lumeve dhe shkelje e monumenteve natyrore	12
Përdorimi i paligjshëm i gurit gëlqeror	13
Menaxhimi i mbeturinave në Kosovë	14
Trajtimi i mbeturinave mjekësore në Kosovë	16
Trajtimi i mbeturinave industriale në Kosovë	17
Ripërdorimi dhe riciklimi	18
Korniza Ligjore e Mbeturinave në Kosovë	19
Përshtatja me Kornizën Ligjore dhe Planifikuese	20
Praktika gjyqësore për krimet mjedisore	21
Analiza e gjykimeve.....	21
Politikat ndëshkuese	22
Lehtësimi i ndëshkimeve në emër të situatës ekonomike	22
Dënimet e ashpra për vjedhje pyelli.....	22
Rruga që duhet ndjekur	24

Hyrje

Ky punim synon të zhvillojë një analizë të rasteve të kornizës ligjore mbi ndotjen e lumenjeve, mbeturinave dhe vendimeve të gjykatës mbi krimet mjedisore në Kosovë. Si një vend që synon të bëhet pjesë e Bashkimit Europian, Kosova i ka vënë detyrim vetës të ketë një legjislacion në përputhje me legjislacionin dhe direktivat e Bashkimit Europian. Korniza ligjore përmban një numër dokumentësh zyrtarë, ligje të miratuara nga institucione të ndryshme shtetërore dhe nivele që rregullojnë këtë temë kaq të ndërlikuar.

Kuvendi ka miratuar ligje të ministrive të ndryshme që e rregullojnë në mënyrë të drejtpërdrejt ose jo të drejtpërdrejt, çështjen e lumenjeve, menaxhimin e mbeturinave dhe monumenteve natyrore. Legjislacioni miratohet kryesisht nga niveli qendror. Monitorimi i zbatimit të legjislacionit në praktikë mbetet në përgjegjësinë e nivelit komunal.

Edhe pse korniza ligjore ka një rol të rëndësishëm, realitetin e shpërfaq më së miri situatë në terren. Shembujt që sjellë ky raport tregojnë problemin e ndotjes së lumenjeve dhe vendimet e gjyqit mbi shkelësit e mjedisit.

Përmbledhje ekzekutive

Metodologjia e Hulumtimit

Mbrojtja e monumenteve natyrore, lumenjëve dhe menaxhimi i mbeturinave janë çështje themelore për një menaxhim të qëndrueshëm mjedisor. Deri më tash, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka themeluar strukturën e nevojshme ligjore për këto tema.

Hulumtimi në terren ka përfshirë lumenjë Drini i Bardhë, Mirusha dhe Ibri dhe përfshinë një analizë të vendimeve të gjykatës mbi disa gjykata komunale. Hulumtimi është bërë me video inçizim të lumenjëv si dhe përmes diskutimeve me përfaqësuesë të institucioneve qendrore dhe komunale, ekspertë, qytetarë dhe kompani që gjenden rreth këtyre lumenjëve. Ky hulumtim tregon se situatë në terren është larg përmbushjes së standardeve Europiane, dhe në shpërputhje me kornizën e tanishme ligjore në Kosovë.

Për të vlerësuar gjendjen e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë është nevojitur një hulumtim cilësor. Qëllimi i këtij hulumtimi është që të ofrojë një pasqyrë gjithëpërfshirëse mbi informacionin e gatshëm (që ekziston) dhe të ofrojë njohuri që do të mund të ndihmonin në vendimmarrjen e projektit ose në hulumtim të mëtejshëm. Hulumtimi mëton të sjellë informacion të dytë të përditësuar mbi menaxhimin e mbeturinave në Kosovë; ky informacion buron nga një metodë hulumtimi desk research (hulumtimi në tavolinë), përmes së cilës janë mbledhur të dhëna dytësore nga publikimet, studimet, iniciativat, strategjitë, politikat, programet dhe legjisllacioni përkatës. Gjatë hulumtimit përmes kësaj metode, janë rishikuar të dhëna, dokumentet dhe raporte nga burime të besueshme dytësore për të kuptuar kornizën ligjore në Kosovë lidhur me menaxhimin e mbeturinave. Këto burime përfshinë raportet e publikuara nga institucione qeverisëse, organizata ndërkombëtare në Kosovë, statistika zyrtare; po ashtu janë rishikuar, analizuar dhe paraqitur në tabela edhe të dhëna të publikuara nga agjenci zyrtare.

Gjetjet Kryesore

1. Shfrytëzimi i paligjshëm i zhavorrit, derdhja e ujërave të zeza nga qytetarët dhe bizneset në lumenj pa u trajtuar në impiante, mbetjet e shumta në rrjedhat e lumenjve dhe mbetjet inerte përgjatë brigjeve të tyre, janë faktorët kryesorë që po degradojnë pasuritë kryesore natyrore të Kosovës.
2. Ndotja më e madhe e lumit shkaktohet nga derdhja e ujërave të zeza nga shtëpitë dhe bizneset, "ishujt" e qeseve plastike dhe mbeturina tjera.
3. Fshatrat përreth lumenjve përballen ende me mungesën e rrjetit të kanalizimit.
4. Deponimi në deponitë sanitare mbetet problem madhor në nivel kombëtar.
5. Buxheti për sektorin e ujit është i pamjaftueshëm dhe shqetësimet për mjedisin dhe klimën përfshihen në politika tjera.
6. Kosovës i mungojnë kapacitetet e mjaftueshme njerëzore, administrative dhe kapitale për të zbatuar standardet e BE-së për ujin, mjedisin dhe klimën.
7. Mungesa e veprimt drejt një ekonomie rrethore dhe mangësitë në mbledhjen dhe raportimin e të dhënave vazhdojnë të jenë sfiduese.
8. Dënimet gjyqësore janë shumë të ulëta dhe nuk japin efektin e dëshiruar.
9. Mungesa e teknologjive alternative të menaxhimit të mbeturinave.
10. Sfida e bashkëpunimit / komunikimit ndërmjet pushtetit qendror dhe atij vendor mbi përgjegjësitë dhe veprimet.

Korniza

Shumica e burimeve ujore në Kosovë janë të brendshme; përjashtim bën pjesa e epërme e lumit Ibër që është në Mal të Zi por që derdhet në liqenin e Gazivodës. Pellgu i lumit Drin është një nga katë pellgjet e lumenjëve në Kosovë. Ai ndodhet në pjesën perëndimore të vendit, midis maleve të Moknas në veri dhe maleve të Sharrit në jug. Është pellgu më i madh lumor dhe mbulon një sipërfaqe prej 4,660 km katrorë ose rreth 42.8% të territorit të Kosovës, dhe është pellgu më i pasur në Kosovë sa i përket sipërfaqes dhe disponueshmërisë shumëvjeçare të ujërave nëntokësor. Peja, Gjakova dhe Prizreni janë komunat kryesore të këtij pellgu, me 30% të popullësisë totale të vendit. Cilësia e ujit mbitokësor dhe nëntokësor po zbehet nga ndotja prej ujërave të zeza të patrajtuara dhe deponitë e mbeturinave të komunave dhe industrive.

Uji dhe mjedisi në Kosovë përballen me sfida të mëdha: shumica e nivele të ndotjes shkojnë shumë përtej nivele që përcakton BE-ja dhe një pjesë e madhe e populates nuk ka lidhje me rrjetin e furnizimit ose të kanalizimit. Ujërat e zeza nga qyteti dhe industria derdhen drejt-përdrejt në lumenj pas asnjë trajtim paraprak. Prandaj, cilësia e ujit në shumicën e lumenjëve në Kosovë është dukëshëm më e ulët sesa niveli i cilësisë së ujit të përcaktuar me standardet e BE-së.

Sa i përket deponisë së mbeturinave, si një nga sfidat më të mëdha, shumica e raporteve bazë përqëndrohen mbi mbeturinat e ngurta komunale (MNK). Ka të dhëna mbi MNK-në. Edhe pse nuk janë gjithëpërfshirëse, këto të dhëna janë të mjaftueshme për të vendosur bazën dhe cakun.



580,000 ton

MNK konsiderohet se prodhohen

420,000 ton

(74% e totalit MNK) konsiderohen si të menaxhuara (mbledhur dhe depozituar).

290,000 ton

(50% e totalit të MNK) konsiderohen si mbeturina komunale të biodegradueshme.

90,000 ton

(15% e totalit të MNK) konsiderohen si të ambalazuara (letër, plastikë, qelq, metal).

Gjithsej MNK
580,000 tonë

Të menaxhuar
420,000 tonë

Të biodegradueshme
290,000 tonë

Të ambalazhit
90,000 tonë

26%
Shërbimet



47%
Amvisëritë

19%
Minierat dhe guroret

1%
Aktivitetet e tjera

7%
Prodhimi

Fraksione tjera mbeturinash, në veçanti burime të ndryshme dhe lloje të mbeturinave industriale nuk janë studiuar plotësisht dhe për pasojë, të dhënat mungojnë krejtësisht. Fare pak dihet për natyrën dhe sasinë e mbeturinave tjera jo komunale (p.sh të atyre nga industria, minierat etj) që prodhohen nëpër të gjithë Kosovën.

Sipas statistikave zyrtare të Eurostat, Kosova prodhon 1 milion ton mbeturina. Në këto të dhëna, mungonin statistikave për mbeturinat e ndërtimit dhe prishjes, dhe të termocentraleve. Mbeshtetur mbi një ushtrim përditësimi të dhënash i kryer gjatë përgatitjes së kësaj Strategjie, një vlerësim i rishikuar i sasisë totale tregon se Kosova prodhon 1.4 milion ton mbeturina.

Grafiku i mëposhtëm tregon proporcionet e prodhuara nga të katër burimet kryesore të mbeturinave.

15%q
Miniera dhe gurore



43%
Komunale

13%
Të ndërtimit dhe rrënim

29%
Industriale

Me përjashtim të mbeturinave komunale, këto vlerësime mbeten të përafërta meqë nuk janë përfshirë nga mbledhja e të dhënave të sakta dhe nga sisteme raportimi. Vlerësimet do të përditësohen në rishikimet e mëpastajme të Strategjisë kurdo që t'i kemi të gatshme të dhënat e përmirësuara.

Ndotja e lumenve dhe shkelje e monumenteve natyrore

Ky seksion synon të paraqes çështjen e ndotjes së lumenjve dhe shkeljen e monumenteve natyrore në Kosovë në një mënyrë të përshtatshme për një dokument politik. Ndërkaq, është e rëndësishme që të trajtohet me objektivitet dhe qartësi, pasi kjo është një prej sfidave kryesore që duhet adresuar në politikat tona mjedisore.

Lumenjtë në Kosovë po vazhdojnë të përballen me ndotje dhe degradim të konsiderueshëm, pasi autoritetet shtetërore nuk kanë arritur të mbrojnë dhe denojnë ata që shkaktojnë dëmin. Ndotja e tyre është rezultat i disa faktorëve kryesorë, përfshirë eksploatimin ilegal të zhavorrit, derdhjen e kanalizimeve të pa trajtuara nga qytetarët dhe bizneset, akumulimin e mbeturinave në lumenj dhe rrjedhat e tyre, si dhe shkatërrimin e brigjeve të tyre.

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës ka konfirmuar nivelin e ndotjes së lumenjve në vend. Bashkim Kastrati, një përfaqësues i këtij instituti, ka deklaruar se shumica e lumenjve në Kosovë janë në gjendje të rëndë apo të keqe, duke përfshirë edhe cilësinë fizike dhe përmbajtjen e tyre të ndotur me materie dhe substancat kimike të rrezikshme nga industritë dhe burime të tjera.

Ndër faktorët që po kontribuojnë në ndotjen e lumenjve janë edhe nxjerrja e zhavorrit dhe mungesa e rehabilitimit të shtratit dhe brigjeve të tyre. Edhe lumi Drini i Bardhë, një nga lumenjtë më të bukur në Kosovë, nuk është i përjashtuar nga ndotja. Banorët e kësaj zone dëshmojnë për degradimin e tij të vazhdueshëm.

Ky lloj degradimi është i rëndësishëm jo vetëm për shëndetin e lumenjve, por edhe për shëndetin e komuniteteve që jetojnë në afërsi të tyre. Dërdhja e kanalizimeve pa trajtuar dhe ndotja nga eksploatimi ilegal i zhavorrit janë shqetësuese, dhe autoritetet duhet të marrin masa të menjëhershme për të ndaluar këtë trend.

Po ashtu, është e rëndësishme të theksohet se disa biznese në afërsi të lumenjve nuk kanë ndërtuar impiante për trajtimin e ujërave të zeza, duke ndikuar negativisht në cilësinë e ujërave të tyre dhe në mjedisin rrethues. Në këtë kontekst, autoritetet duhet të kujdesen që ligjet dhe rregulloret të ndjekura në lidhje me trajtimin e ujërave të zeza të zbatohen me rigorozitet.



Lumenjtë në Kosovë po vazhdojnë të përballen me ndotje dhe degradim të konsiderueshëm, pasi autoritetet shtetërore nuk kanë arritur të mbrojnë dhe denojnë ata që shkaktojnë dëmin.

Po ashtu, ekziston një problem i shpërndarjes së qeseve të plastikës në ambientet natyrore, duke përfshirë lumenjtë. Kjo është një shqetësim i rëndësishëm për mjedisin dhe monumentet natyrore të Kosovës. Bashkësia duhet të edukohet dhe të ndërmarrë veprime për të parandaluar ndotjen e mëtejshme të mjedisit me qese të plastikës, të cilat janë të dëmshme dhe ngelën për shumë vite në mjedis.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të përmendet se ndërsa përpjekjet janë në zhvillim për të kufizuar përdorimin e qeseve të plastikës në Kosovë, ende nuk janë ndërmarrë masa të mjaftueshme për të kontrolluar dhe rregulluar problemet e ndotjes dhe shkatërrimit të lumenjve dhe mjedisit në përgjithësi.

Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet se eksploatimi ilegal i zhavorrit është një shqetësim i rëndësishëm që duhet adresuar. Një numër i lartë i raporteve për eksportin ilegal të rërës dhe zhavorrit tregon për një nivel të lartë të aktivitetit të paligjshëm në këtë fushë.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme që autoritetet të ndërmerren masa për të ndaluar eksploatimin ilegal të zhavorrit dhe të rregullojnë sektorin e tij në përputhje me ligjet dhe rregulloret relevante. Përmirësimi i zbatimit të ligjeve dhe dënimit më të rënda për ata që shkelin ligjet mjedisore janë hapa të rëndësishëm për të adresuar këtë problem.

Në përfundim, është e nevojshme që politikat dhe masat e politikave në Kosovë të përqëndrohen në mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit natyror të vendit, duke përfshirë lumenjtë dhe monumentet natyrore. Kjo kërkon bashkëpunim të ngushtë mes autoriteteve qendrore dhe lokale, komuniteteve të vendit dhe organizatave mjedisore për të garantuar që Kosova të ketë një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm për të ardhmen.

Përdorimi i paligjshëm i gurit gëlqeror

Gërryerja e pakontrolluar e zallit dhe zhavorrit nga gërryes ilegal ka shkaktuar dëmtim të plotë të shtretërve të lumenjëve, duke i kthyer ata në pellgje të vogla me biodiversitet të shkatërruar. Shfrytëzimi i skajshëm dhe i pakontrolluar i lumenjëve e ka prishur ekuilibrin ekologjik të natyrës – në veçanti ka dëmtuar shtratin e lumit – që rrit rrezikun e vërshimeve gjatë reshjeve atmosferike. Për më tepër, ndotja nga pluhuri i makinerive të përpunimit të zhavorrit ka shkatërruar florën përreth.

Rreth 1,100 hektarë të lumenjëve në Kosovë janë zona të degraduara. Lumi më i dëmtuar është Drini i Bardhë, më i gjati në vend që rrjedh nëpër të gjithë regjionin e Dukagjinit; më pas vjen Lumbardhi që rrjedh në komunën e Pejës dhe Erenikut të Gjakovës.

Gjykatat kanë dënuar ata që kanë përdorur gur gëlqeror në mënyrë jo ligjore; për këtë veprë penale, njëziti janë dënuar vetëm me gjobë. Gjykata Themelore e Ferizajit ka gjjobitur një person me 1000 euro për përdorim jo ligjor të gurit gëlqeror, edhe pse i njëjti e ka përsëritur krimin. Për dhënie të këtij dënimi, gjykata ka dhënë arsyetimin se dënimi i dhënë është në përpjestim me veprën penale dhe sjelljen e të pandehurit. Në arsyetimin e gjykatës, thuhet se dënimi i shqiptuar është i drejtë në raport me shkallën e rrezikimit të vlerave të mbrojtura duke vënë në pah se vendimi për dënim do të ndikojë tek i akuzuari që të shmang kryerjen e veprave penale në të ardhme dhe do të forcojë respektimin e ligjit. Gjykata kanë dhënë gjithë këtë arsyetim kur ka dënuar të pandehurin, i cili përsërit kryerjen e veprave penale. Madje në verdiktin e lëshuar, është vërtetuar se i njëjti person ka kryer edhe gjashtë krime tjera, përfshirë veprën penale të shfrytëzimit të paligjshëm të gurit gëlqeror. Prandaj, ka ardhur në përfundim se i pandehuri ka përsëritur të njëjtën veprë penale, ndaj është dënuar sërish me 1000 euro gjobë.

Menaxhimi i mbeturinave në Kosovë

Mbi të gjitha, sistemi i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë synon të zvogëlojë sasinë e mbeturinave të hedhura në një vend-groposje për mbeturina, të promovojë ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave, dhe të sigurojë menaxhim të sigurtë e të qëndrueshëm mbeturinash në vend. Megjithatë, ende ka sfida në arritjen e këtyre qëllimeve, përfshirë mungesën e infrastrukturës, fondet e pamjaftueshme dhe nivelin e ulët të vetëdijësimit publik dhe pjesëmarrjen në praktikën e menaxhimit të mbeturinave.

Menaxhimi i mbeturinave në Kosovë rregullohet me Ligjin Nr. 64/L-060 dhe me rregullore mbështetëse. Përveç aktivitetit të rritur të aksionarët e menaxhimit të mbeturinave, nuk ka përparim të plotë pa zbatimin e duhur të kërkesave ligjore dhe investimin në projekte konkrete për përmirësim.

Të dhënat e gjithë ciklit të mbeturinave, nga prodhimi të trajtimi përfundimtar, tregojnë përmirësim por ende ka sfida të mëdha. Deponimi i mbeturinave në vend-groposjet sanitare mbetet çështje madhore në vend. Mungesa e veprimit drejt një ekonomie rrethore dhe mangësitë në mbledhjen dhe raportimin e të dhënave vazhdojnë të pengojnë përparimin. Megjithë kufizimet, të dhëna e raportuara u janë nënshtruar verifikimit.

Analizë që kemi bërë ne për menaxhimin e mbeturinave komunale, përfshirë mbeturina e caktuara si ato të kafshëve, mjekësore, ndërtimit dhe mbeturinave të rënda, vë në pah se komunat kanë kapacitete të kufizuara për trajtim të mbeturinave. Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave mbetet sfidë dhe kërkon bashkëpunim mes komunave dhe qeverisë, si dhe investim të rritur përmes ortakërisë me donatorë për të realizuar projekte për një menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave.

Problemet në sektorin e mbeturinave të ngurta komunale janë të njohura mirë dhe janë shpjeguar në mënyrë kronike në disa raporte dhe publikime gjatë viteve të fundit. Ato përfshijnë *Municipal Waste Management in Kosovo, Status Report (2018)*, *The State of Waste and Chemicals (2014)* dhe *Report on Environmental Hotspots (2011)* të botuara nga Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.

Kosova po përballlet me një situatë kritike sa i përket kapacitetit të vend-groposjes për mbeturina, duke mos i plotësuar standardet e BE-së për direktivat që përcaktojnë vend-groposjet për mbeturina. Një përparësi e menjëherëshme është zhvillimi i objekteve modern për menaxhim të mbeturinave dhe sistemeve të përmirësuara për grumbullim, përfshirë grumbullimin ndaras në bazë të llojeve të mbeturinave me qëllim parandalimin e përshkallëzimit të mëtejshëm të shëndetit mjedisor dhe publik.

Programi për investim është formuluar dhe përfshirë në Single Project Pipeline.

Lista e vetme e projekteve prioritare		Buxheti i parashikuar
1	Ndërtimi i transfer stacionit dhe qendrës për ndarjete mbeturinave në (Klinë, Istog, Skenderaj, Novo-bërdë)	2,010,000
2	Ndërtimi i transfer stacionit dhe qendrës për ndarjen e mbeturinave në Ferizaj	5,255,292
3	Ndërtimi i qendrës për ndarjete mbeturinave dhe qendrës për kompostim në Prizren	5,254,000
4	Ndërtimi i qendrës për ndarjete mbeturinave në Pejë	3,495,708
5	Ndërtimi i qendrave për magazinimin e mbeturinave të rrezikshme	12,000,000
6	Përmirësimi i gjendjes teknike dhe operative në de-poninë e rajonit të Prishtinës në Mirash - Obiliq	3,220,000
7	Përmirësimi dhe zgjerimi i deponisë ekzistuese në Pejë	3,850,000
8	Përmirësimi dhe zgjerimi i deponisë ekzistuese në Dragash	2,295,600
9	Ndërtimi i qendrave për trajtimin e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimin në komunat e Kosovës	7,900,000
Gjithsej		45,280,600

Përmirësime në zhdukjen e vend-groposjeve për mbeturina janë vërejtur në komunat me zbatim të shtuar përmes inspektimeve dhe vërejtjeve për moshudhje mbeturinash. Megjithatë, përparim i vogël drejt ekonomisë rrethore dhe qasje të kufizuar në infrastrukturën

për klasifikim në burim të mbeturinave. Përveç pabarazisë regjionale në menaxhim të mbeturinave, po shënohet përparim vit për vit në përmirësimin e ndikimit mjedisor nga menaxhimi i keq i mbeturinave.

Trajtimi i mbeturinave mjekësore në Kosovë

Menaxhimi i mbeturinave mjekësore në Kosovë rregullohet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e cila është përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e rregulloreve mbi menaxhimin e mbeturinave në vend. Mbeturinat mjekësore në Kosovë klasifikohen si mbeturina të rrezikshme dhe u nënshtrohen kërkesave të veçanta për menaxhim, përfshirë grumbullimin e duhur, transportimin dhe asgjësimin. Megjithatë, është gjë e rëndomtë që mbeturinat mjekësore të përzihen me lloje të tjera mbeturinash, gjë që mund të paraqes rrezik për shëndetin publik dhe mjedisin.

Për t'i trajtuar këto sfida, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka themeluar planin për menaxhimin e mbeturinave dhe strategjinë e asgjësimit të sigurtë të mbeturinave të rrezikshme, përfshirë mbeturinat mjekësore. Plani përfshinë masa për përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave mjekësore, siç është rritja e kapacitetit të objekteve të përkujdesit shëndetësor për trajtimin e duhur dhe hedhjen e mbeturinave mjekësore, dhe përmirësimin e grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave mjekësore për të garantuar asgjësimin e sigurtë e të përgjegjshëm të tyre.

Trajtimi i mbeturinave industriale në Kosovë

Trajtimi i mbeturinave industriale në Kosovë rregullohet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e cila është përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e rregulloreve për menaxhimin e mbeturinave në vend. Trajtimi i mbeturinave industriale mbetet sfidë për shkak të mungesës së infrastrukturës së duhur dhe kapacitetit.

Mbeturinat industriale klasifikohen si mbeturina të rrezikshme ose jo të rrezikshme dhe u nënshtrohen kërkesave të veçanta për menaxhim, përfshirë grumbullimin e duhur, transportimin dhe hudhjen. Është gjë e rëndomtë që mbeturinat industrial të përzihen me lloje

tjera të mbeturinave, gjë që mund të paraqes rrezik për shëndetin publik dhe mjedisin.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka krijuar planin që trajton çështjet e menaxhimit të mbeturinave, dhe strategjinë për asgjësimin e sigurtë të mbeturinave të rrezikshme, përfshirë mbeturinat industriale. Plani kërkon veprime që rrisin menaxhimin e mbeturinave industriale, siç janë rritja e kapacitetit të objekteve industriale për trajtimin dhe hudhjen e duhur të mbeturinave dhe rritjen e grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave industrial për të garantuar asgjësim të sigurtë e të përgjegjshëm të mbeturinave.

Ripërdorimi dhe riciklimi

Ripërdorimi dhe riciklimi janë objektivi kryesor strategjik, edhe në kuptimin e rritjes ekonomike të Kosovës edhe në kuptimin e arritjes së objektivave Europiane.

Kosova dëshiron të kontribuojë në qëllimin e Europës për një Shoqëri Riciklimi. Faza e pare do të jetë themelimi i mekanizmave funksionalë për ripërdorim dhe riciklim.

Objektivat strategjike	2021	2022	2023	Gjithsej
Objektivi strategjik 1: Shërbimet dhe infrastruktura	6.134.673	19.244.330	19.749.890	45.128.892
Objektivi strategjik 2: Profesionalizimi i sektorit të mbeturinave dhe riciklimit	405.000	555.000	169.000	1.129.000
Objektivi strategjik 3: Rregullimi dhe kontrolli	963.000	4.339.000	3.670.250	8.972.250
Objektivi strategjik 4: Ekonomia qarkore	551.000	833.000	1.669.737	3.053.737
			Gjithsej	58.283.879

Korniza Ligjore e Mbeturine në Kosovë

Në këtë kontekst, Kosova po i harmonizon ligjet dhe rregulloret e menaxhimit të mbeturinave me direktivat e BE-së për menaxhim të mbeturinave, siç janë Direktiva Kornizë e Mbeturine dhe Direktiva e Deponisë. Qëllimi i harmonizimit është që Kosova të ketë një sistem efikas të menaxhimit të mbeturinave që përmbush standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira.

Megjithatë, ende mbetet punë për t'u bërë për një harmonizim të plotë të kornizës për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë me direktivat e BE-së, dhe nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar praktikën e menaxhimit të mbeturinave në vend.

Korniza ligjore për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë udhërhiqet kryesisht nga këto ligje dhe rregulloret:

- Ligji për Menaxhimin e Mbeturine – ky ligj cakton përgjegjësitë e palëve të interesuara në sistemin e menaxhimit të mbeturinave, siç janë qeveria, sektori privat dhe bashkësitë komunale.
- Rregulloret për Menaxhimin e Mbeturine – këto rregulloret japin më shumë detaje për zbatimin e ligjit, siç janë kërkesat për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave, asgjësimi, dhe trajtimi.
- Ligji për Mbrojtjen e Ambientit – ky ligj cakton një kornizë të përgjithshme për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë, për fshirë dispozitat që lidhen me menaxhimin e mbeturinave.
- Rregulloret e Deponive – këto rregulloret përcaktojnë standardet dhe kërkesat për punën dhe mbylljen e deponive në Kosovë.

- Rregulloret për Menaxhimin e Mbeturine të Rrezikshme – këto rregulloret caktojnë kërkesat e veçanta për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme, përfshirë trajtimin, deponimin, transportimin dhe asgjësimin e mbeturinave.

Për të mbështetur zbatimin e Ligjit për Menaxhimin e Mbeturine, Kosova ka themeluar disa institucione dhe agjenci, përfshirë:

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor – është përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve për menaxhimin e mbeturinave, dhe për mbikqyrjen e sektorit të menaxhimit të mbeturinave.

Inspektoriati i Mjedisit – është përgjegjës për zbatimin e ligjeve dhe rregulloret, përfshirë ato që lidhen me menaxhimin e mbeturinave.

Agjencia e Kosovës për Menaxhimin e Mbeturine – është përgjegjës për menaxhimin dhe mbikqyrjen e punës së deponive dhe objekteve tjera për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë.

Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit – është përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e gjendjes së ambientit, përfshirë praktikën për menaxhimin e mbeturinave.

Përshtatja me Kornizën Ligjore dhe Planifikuese













Brenda kornizës ligjore që mbulon fushën e menaxhimit të mbeturinave, duhet vënë theksin te Ligji Nr.04/L-60 mbi Mbeturinat, prej të cilit dalin nënligje dhe dokumente tjera planifikimi të nivelit qendror dhe komunal. Ky ligj përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e komunave për menaxhimin e mbeturinave brenda territoreve të tyre. Gjithashtu, ligji ofron një kornizë zhvillimore për nivelin komunal dhe regjional dhe ndërmerr masa për t'i përmbushur qëllimet dhe objektivat e caktuara.

Ja disa nga obligimet që dalin nga baza ligjore, përmbushja e të cilave është thelbësore për t'u mundësuar komunave të zbatojnë ligjin dhe planet për menaxhimin e mbeturinave

1. Hartimi dhe përvetësimi i Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave;
2. Hartimi dhe përvetësimi i Planit për Menaxhimin e Mbeturinave Komunalre (PMMK);
3. Punësimi me orar të plotë i Zyrtarit për Menaxhimin e Mbeturinave, përshkrimin i detyrave të tij garanton se të paktën 50% e përgjegjësive të tij mbulojnë menaxhimin e mbeturinave;
4. Punësimi i një inspektori të mjedisit, puna e të cilit garanton përgjegjësitë për menaxhim të mbeturinave;
5. Kontraktimi i operatorëve të licensuar për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave komunale, duke zbatuar procedurat e prokurimit.
6. Kontraktimi i operatorëve të licensuar për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe prishja e vendeve të ndërtimit, duke zbatuar procedurat e prokurimit;
7. Caktimi i tarifave të shërbimit përmes procesit të tarifave për mbledhjen, transportimin dhe asgjësimin e mbeturinave komunale, duke përlllogaritur kostot e shërbimit, profilizimin e klientëve dhe caktimin e tarifave të shërbimit;
8. Përcaktimi i një objekti për mbledhjen, trajtimin, dhe asgjësimin e mbeturinave të ndërtimit dhe prishjes së ndërtesave;
9. Struktura e organizimit të inspektoriatit komunal; dhe
10. Shqiptimi i gjobave të detyrueshme.

Problemi dhe shkaqet e tij

Objektivat strategjike dhe specifike

 PROBLEMI: Kërkesat ligjore nuk zbatohen si rezultat i mungesës së qartësisë dhe mekanizmave të dobët të zbatimit.		 Objektivi strategjik: Forcimi i rregullimit dhe kontrollit në sektorin e menaxhimit të mbeturinave duke i plotësuar boshllëqet dhe duke i qartësuar mekanizmat e zbatimit.
 SHKAKU: Nuk ekziston ndonjë sistem për mbledhjen rutinore të të dhënave dhe informacionit për menaxhimin e mbeturinave.		 Objektivi specifik: Krijimi i një sistemi informativ gjithëpërfshirës dhe funksional për menaxhimin e mbeturinave.
 SHKAKU: Licencat dhe lejet për objektet industriale dhe operatorët dhe objektet e menaxhimit të mbeturinave janë të paplota.		 Objektivi specifik: Zgjerimi i sistemit të dhënies së licencave dhe lejeve për menaxhimin e mbeturinave për t'i mbuluar të gjitha mbeturinat, operatorët dhe qendrat e menaxhimit të mbeturinave.
 SHKAKU: Mekanizmat e zbatimit janë joefektivë.		 Objektivi specifik: Forcimi i mekanizmave zbatues, përfshirë komunat dhe inspektoratet.

Praktika gjyqësore për krimet mjedisore

Kriminalët e mjedisit nuk dënohen për krime në Kosovë. Gjykatat po u shqiptojnë vetëm gjopa monetare atyre që kanë kryer krime ndaj mjedisit, përfshirë minierat e zhavorrit, hedhjen e mbeturinave inerte në shtretërit e lumenjve dhe dëmtimin e pyjeve. Të vetmit që janë dënuar për krime ndaj mjedisit dhe janë burgosur janë ata që janë kapur në prerje të paligjshme. Nga 50 gjykime të shtjelluara, kishte raste kur shqiptohet gjobë prej 200 eurosh për një dëm të shkakuar në vlerë prej 16 mijë eurove. Të akuzuarit i është shqiptuar një gjobë kaq e ulët edhe pse gjykata kishte zbuluar se i njëjti person është shpallur fajtor 6 herë për krime të ngjashme ndaj mjedisit. Gjatë analizës së vendimit të gjykatës, është vënë re se gjykatat kanë dyfishuar rrethanat lehtësuese dhe kanë shqiptuar dënime minimale për dëmtim të mjedisit, edhe pse këto dënime nuk kanë ndikuar në zvogëlimin e krimeve ndaj mjedisit. Meqë kemi patur disa raste ku i njëjti person ka kryer krime ndaj mjedisit vazhdimisht, atëherë kemi ardhur në përfundim të këtij parametri të qartë.

Për të hulumtuar trajtimin e veprave penale ndaj mjedisit, BIRN-i kërkoi të dhëna nga Këshilli i Prokurorisë dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Nga përgjigjet e pranuar, mund të vërehet se Këshilli i Prokurorisë nuk ka të dhëna statistikore për proceset e veprave penale ndaj mjedisit. “Zyra e Statistikave nuk ka të dhëna në Kapitullin XXVII – Veprat penale ndaj mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore”, thuhet në përgjigjen e pranuar nga Zyra e Prokurorit të Shtetit për KALLXO.com. Ndërsa Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka të dhëna statistikore lehtësisht të qasshme për publikun për periudhën 2015-2019; ndërsa për vitet më pas BIRN-i pop ret ende përgjigje nga ky institucion. Kodi Kriminal i Kosovës thotë se çdo person që shkakton ndotjen, degradimin dhe shkatërrimin e ajrit, ujit dhe tokës ose mbipërdorë burimet natyrore duhet dënuar me gjobë ose burgim deri në dy vite.

Sa u përket atyre që shkaktojnë ndotjen dhe degradimin e mjedisit nga pakujdesia, ligji ka paraparë që i njëjti do të dënohet me gjobë ose burgim deri në 1 vit. Dhe në shumicën e rasteve të rënda, kur për shkak të kryerjes së veprës penale, rrezikohet shëndeti i një numri të madh njerëzish, ose dëmtohet plotësisht ose pjesërisht bota bimore ose shtazore, atëherë kryesi i veprës mund të dënohet deri në 5 vite burgim. Për rastet e dëmtimit/shkatërrimit të pariparueshëm të mjedisit, kryesi mund të dënohet me 8 vite burgim.

Analiza e gjykimeve

BIRN-i ka analizuar 50 verdikte për dënimin e veprave pengale ndaj mjedisit. Analiza e verdikteve të gjykatës së rregullt tregon se si ndotësit ndaj ajrit dhe lumnjve dënohen më së shumti me gjobë, për dallim nga ata që prejnjë pyjet, të cilëve gjykata u shqipton dënime me kusht; ndërsa për rastet ku dënohen me gjobë, vlera e gjobës është më e lartë.

Të dyja këto vepra penale i përkasin të njëjtit kapitull, meqë bëjnë pjesë në veprat që konsiderohen si vepra penale ndaj mjedisit. Për ata që me vetëdije dhe qëllim shkaktojnë ndotje, degradim dhe shkatërrim të ajrit, ujit ose tokës, ligji parasheh mundësi dënimi minimal me gjobë ose burgim deri në dy vite. Ndërsa për ata, që për qëllim vjedhjeje, prejnjë drurin në sasira që tejkalojnë dy metër kub, kryesi mund të dënohet me gjobë minimale ose burgim deri në një vit. Prandaj, ndëshkimet për vjedhje të pyllit pritet të jenë më të vogla sesa ato që degradojnë mjedisin. Megjithatë, analiza tregon se praktika gjyqësore në Kosovë dënon më ashpër vjedhjen e pyjeve sesa ndotjen, degradimin dhe shkatërrimin e ajrit, ujit dhe tokës. Dukuria negative e rasteve të shpeshta të dëmtimeve mjedisore si ndotja, shkatërrimi apo degradimi i ajrit dhe ujit është shqetësuese në raport me masat e marra për mbrojtjen e këtyre burimeve të rralla natyrore.

Politikat ndëshkuese

Të dhënat nga analiza e gjykimeve tregojnë faktin se kur maten rrethana lehtësuese dhe rënduese, gjykatat dyfishojnë masën e rrethanave lehtësuese. Kodi Kriminal parasheh si masa lehtësuese pranimin e fajit dhe shprehjen e keqardhjes nga i pandehuri. Me Udhëzuesin e Politikës Ndëshkimore, mund të argumentohet se shpallja fajtor është dëshmi pendimi; ndaj dhe mund të merret parasysh nga gjykata për dhënien e vlerësimit se vërtet kemi dëshmi pendimi. Prandaj, i akuzuari kur shpallet fajtor tregon se po merr përgjegjësi për veprimet e veta dhe se ndihet i keqardhur për ato veprime. Edhe pse kjo mund të duket bindëse, në të dyja rastet gjykata duhet t'i atribuojë faktet për vetëm një rrethanë lehtësuese.

Duke ia mveshur këtë më shumë se një rrethane lehtësuese, gjykata kryen një përlllogaritje të dyfishtë për faktet e dhëna dhe padrejtësisht merr parasysh më shumë rrethana lehtësuese se sa që përcakton udhëzuesi. Nga analiza e gjykimeve në fjalë, ka raste të dyfishimit të rrethanave lehtësuese kur i akuzuari pranon fajlin dhe kërkimfalja dhe shprehja e keqardhjes merren si bazë dhe trajtohen si dy rrethana e jo si një. Përveç dëmit të shkaktuar ndaj mjedisit, dënimet e shqiptuara nga gjykatat janë simbolike dhe në shpërpjestim me dëmin e shkaktuar.

Lehtësimi i ndëshkimeve në emër të situatës ekonomike

Në një tjetër rast, Gjykata e Gjilanit ka dënuar një person me 400 euro gjobë për vepër penal për shkakt të ndikimit në një veprimtarie të paligjshme të minierave që vepronë pa u licencuar nga organi kompetent. Edhe në këtë rast, gjatë gjykimit ishte shpallur se personi ka përsëritur krimin dhe ishte shpallur fajtor edhe për vepra tjera penale. Në një tjetër rast, Gjykata e Pejës kishte dënuar një person me 300 euro gjobë edhe pse ishte vërtetuar se i njëjti kishte shkaktuar dëme në vlerë prej 5 mijë eurove. Rasti ka ndodhur në 2017 dhe ishte dërguar në Gjykatë nga inspektorët e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), meqë i njëjti person ishte zënë duke bërë përpunimin e burimeve minerale dhe atyre të rërës dhe zhavorit. Në arsyetimin e vendimit të Gjykatës,

gjykatësi i rastit nuk kishte vërtetuar ndonjë rrethanë rënduese në veprimet e të akuzuarit. “Gjykatësi nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese në këtë rast, përderisa ka vlerësuar rrethanat lehtësuese: pranimin e sinqertë të fajit, shprehjen e keqardhjes së thellë, sjelljen e drejtë në gjykatë, dhe faktin që i pandehuri është i vetmi i punësuar në familjen e tij 6 anëtarëshe, e shtyen gjykatësin të mendojë se qëllimi arrihet edhe me një dënim të shqiptuar si në dispozitë të aktgjykim-it”, thuhet në vendimin e Gjykatës së Pejës.

E njëjta gjykatë ka dënuar një person me 6 muaj prove dhe me 300 euro gjobë për vepër penale si vjedhje e pyllit. I akuzuari u shpall fajtor nga Gjykata e Pejës për vjedhjen e pyllit meqë ishte kapur duke prerë në mënyrë të paligjshme Parkun Kombëtar të Bjeshkëve të Nemuna. Vlera e demit të shkaktuar ishte afërsisht 400 euro.

Një tjetër rast i analizuar nga BIRN-i ishte një rast i gjykuar në Gjykatën e Gjakovës kundër një person që kishte hedhur mbeturina ose mbetjet e një materiali ndërtimor në lum, me ç'rast kishte ndotur mjedisin dhe rrezikuar jetën dhe shëndetin njerëzor. Për këtë veprim, e njëjta gjykatë i kishte shqiptuar dënim dy mujor me kusht, i cili nuk do të përfillej në rast se i akuzuari nuk kryen vepra tjera penal brenda një peridhe verifikimi prej 1 viti.

Dënimet e ashpra për vjedhje pyelli

BIRN-i ka analizuar gjithashtu një vendim tjetër të marrë nga Gjykata e Gjakovës, e cila kishte dënuar me 220 euro gjobë një person të akuzuar për dëme të shkaktuara në vlerë prej 16 mijë eurove.

Gjykata ka vërtetuar se i akuzuari, përmes një ekskavatori të përdorur pa licencë dhe në mënyrë të paligjshme, ka shfrytëzuar pasuritë natyrore së tepërmi, për t'i përvetësuar paligjshëm ato pasuri, në kundërshtim me Ligjin për Miniera dhe Minerale, duke i shkaktuar shtetit dëme të konsiderueshme. Gjykata e Mitrovicës e kishte dënuar të akuzuarin me 400 gjobë për vjedhjen e 18 trungjeve druri në trashësi 20 cm. Gjykata e Gjilanit e kishte dënuar një person me 550 euro gjobë për të njëjtën vepër penale të ndotjes, degrad-

imit dhe shkatërrimit të mjedisit kundër të akuzuarit që i kishte shkaktuar dëme shtetit në vlerë mbi 5 eurove. E njëjta gjykatë kishte shqiptuar denim me kusht 6 mujor për shkelje të pyellit, edhe pse dëmet që i kishte shtetit

kapnin vlerën e 400 eurove. Në rastin në fjalë, Gjykata ka marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë kriminale dhe rrezikut të veprës penale si rrethanë rënduese.

Rruga që duhet ndjekur

Kosova mbetet ende në fazat e hershme të themelimit të ekonomisë rrethore, me shumë hapësirë për mirësimi në fushat e menaxhimit të mbeturinave. Ndaj duhet përmirësim i praktikave dhe zbatim efikas i legjislacionit aktual nga të gjitha palët për të trajtuar çështjen e keqmenaxhimit të mbeturinave dhe praktikave jashtëligjshme. Qëllimi i anëtarësimit në BE ofron një mundësi për Kosovën dhe rajonin që të kalojnë nga një model ekonomik linear në një ekonomi rrethore, por për të promovuar këtë ndryshim janë të rëndësishme fushatat e avokimit dhe ndërgjegjësimit.

Mbështetur mbi sfidat e tanishme në systemin e menaxhimit të mbeturinave, po japim këto rekomandime për ta përmirësuar situatën:

- Rregullimi i shtretërve dhe brigjeve të lumenjve është i nevojshëm
- Duhet forcuar zbatimin e rregullore të tanishme për menaxhimin e mbeturinave dhe duhet garantuar se të gjitha palët e interesuara i respektojnë rregullat.
- Të rritet numri i inspektorëve dhe të forcohet mbështetja e këtij institucioni.
- Të krijohen task forca të cilat do të mund të kryenin analizën dhe ekspertizën për ndërtimin e shtretërve të lumenjve me qëllim shmangien e dëmtimeve nga vërshimet.
- Të gjitha fshatrat rreth lumenjve kryesorë duhet të pajisen me kanalizim që ai ujë të derdhet në mbledhës.
- Të sigurohet ndihmë teknike dhe financiare bashkësive komunale për të mbrojtur mjedisin.
- Të rriten dukshëm dënimet kundër veprave penale ndaj mjedisit.
- Të rritet numri i inspektorëve në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale që të inspektojnë eksploatuesit ilegal të zhavorrit.
- Të promovohet rritje e ndërgjegjësimit publik dhe edukatës për mbrojtjen e monumenteve natyrore dhe parqeve për rritje të angazhimit dhe pjesëmarrjes së komunitetit.
- Të nxitet përfshirja e sektorit privat në mbrojtjen e mjedisit duke ofruar stimuj për kompanitë që përvetësojnë praktika miqësore ndaj mjedisit.
- Të nxitet zvogëlimi i shfrytëzimit të mjedisit në burim, përmes programeve që promovojnë ripërdorimin e produkteve dhe materialeve.
- Të zhvillohen teknologji alternative për menaxhimin e mbeturinave, siç janë objektet e mbeturinave në energji që zvogëlojnë numrin e deponive të mbeturinave.
- Të rritet investimi në infrastrukturën e menaxhimit të mbeturinave, siç janë deponitë dhe sistemet e grumbullimit, për të ofruar një zgjidhje të qëndrueshme dhe efikase.
- Të ketë bashkëpunim më të mirë mes nivelit qendror dhe komunal në mbrojtjen e ambientit.

Zbatimi i këtyre rekomandimeve do të mund të ndihmonte në përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë dhe të kontribuonte për një të ardhme më të qëndrueshme e më të jetueshme për të gjithë qytetarët.

Ky raport është publikuar nga Koalicioni i OJQ-ve Demokrasi Plus, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN Kosova), Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike, Shoqata Gorazhdevac Media Group si pjesë e projektit "Mbeshtetje për OJQ-të në Ballkanin Perëndimor", i cili është mbështetur nga Instituti Kombëtar Demokratik - NDI. Përmbajtja e këtij raporti i takon Koalicionit dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pozicionin e NDI.



Përkrahur nga:

